

 POLICIA E SHTETIT	Titulli: projekt procedura standarde: "Rregullat teknike të shoqërimit në polici "		
Data e miratimit: Urdhër : 306, dt. 31.03.2016 Prot. 1739, datë 31.02.2016	Numër:	Nr. Faqeve: 21	Rishikimi fundit: Nr. ____ dt. ____ 2016
Referencë: a. Neni 6/25, 109 /8 ;112/1;115 dhe 122 i Ligjit nr. 108, datë 31.07.2014 "Për Policinë e Shtetit b. Ligji nr. 44/2012 "Për Shëndetin mendor". c. Manuali Nr. 763, datë 27.09. 2011 i Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin & Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar, në Njësitë Policore. d. Kodi Procedurës Penale nenit 251/3 ; 253/2 dhe 295.2; e. Kodi Penal neni 250	Shpërndarë: Gjithë punonjësve të policisë		Fusha: Rendi dhe siguria

I. POLITIKA

Është politikë Policisë së Shtetit që të sigurojë garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut gjatë shoqërimit të personave në mjediset policore ose në vende të tjera, sipas kushteve e rasteve të përcaktuara në ligj.

QËLLIMI

Qëllimi i kësaj procedure është përcaktimi i rregullave teknike dhe standardeve që kanë të bëjnë me shoqërimit, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e policisë dhe atyre të institucioneve/organeve urdhërdhënëse, si dhe të detyrimeve ligjore që kanë punonjësit e policisë për respektimin e garantimin e të drejtave që ju njeh ligji këtyre personave.

II. PËRKUFIZIME :

Shoqërimi - është veprimi administrativ, me karakter detyrues (*me ose pa vullnetin e personit që shoqërohet*) dhe shtrëngues (*qoftë edhe forcërisht*), që kryhet nga punonjësi i policisë për dërgimin e shtetasit në ambientet e policisë ose në institucionet e tjera, sipas përcaktimeve dhe procedurave të parashikuara me ligj e aktet nënligjore.

III. PROCEDURA :

Punonjësit e policisë gjatë veprimtarisë së përditshme për ruajtjen e rendit, sigurisë publike, si dhe për përmbushjen e përgjegjësiive policore e të detyrave të tjera, i lind e drejta dhe nevoja për të kryer shoqërime të shtetasve të ndryshëm në ambientet e mjediset e komisariateve/stacioneve të policisë apo institucioneve të tjera.

E drejta e shoqërimit realizohet, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 109 dhe 122/1, të ligjit " Për policinë e shtetit "

Procedurat për shoqërimin e qytetarëve kanë të bëjnë me :

- Rastet dhe qëllimet e aplikimit të masës së shoqërimit
- Përgjegjësitë e punonjësit të policisë në rastet e shoqërimit
- Zbatimi i të drejtave të njeriut dhe siguria për personin e shoqëruar.
- Dokumentimi i shoqërimit në polici.
- Rregullat teknike të shoqërimit.

IV. RASTET DHE QËLLIMET E APLIKIMIT TË SHOQËRIMIT

Akti/veprimi i shoqërimit të detyrueshëm si akt i shtrëngimit personal, mund të kryhet vetëm kur ekzistojnë kushtet e rastet e përcaktuara në ligj, si :

- A. Për identifikimin e personit;
- B. Si masë mbrojtëse;
- C. Ekzekutimin e një urdhri apo detyrimi të njohur me ligj;
- D. Sqarimin e një rrethane.

A. /1. Për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, kur :

- 1.1 personi refuzon të deklarojë gjeneralitet dhe paraqesë dokumentin e identifikimit;
- 1.2 rezultojnë elementë të mjaftueshëm për të dyshuar se personi ka deklaruar gjeneralitete të rreme;
- 1.3 rezultojnë elementë të mjaftueshëm për të dyshuar se dokumentet e identifikimit të paraqitura prej tij, janë fallco/të rreme.

Punonjësit e policisë kërkojnë dhe kryejnë identifikimin e personit dhe kur ndaj tij nuk ka një procedim penal në rastet kur :

- 1.4 Personi, hyn ose del nga territori i Republikës së Shqipërisë.

B./2. Si masë mbrojtëse, kryhet kur personi është :

- 2.1 I/e paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë;
- 2.2 në gjendje të dehur si rezultat i konsumimit të tepërt të pijeve alkoolike;
- 2.3 në efektet e përdorimit të lëndëve narkotike;
- 2.4 bartës dhe përhapës të sëmundjeve ngjitëse të rënda;
- 2.5 për mbrojtjen e mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose shoqërimin e tij në organin kompetent. Në këtë rast policia kryhen veprime për:
 - a. Gjetjen e të miturit të larguar nga prindërit dhe rikthimin e tij tek prindërit a kujdestari.
 - b. Dërgimin e të miturit në qendrat e kujdesit për të miturit kur është braktisur nga prindërit.

C. /3 Ekzekutimin e një urdhri apo detyrimi të njohur me ligj.

- 3.1 Personin ndaj të cilit ekzekutohet një urdhër i organeve të prokurorisë;
- 3.2 Personin të dënuar me burgim nga gjykata kompetente;

3.3 Personin që nuk zbaton urdhrat e ligjshëm të gjykatës ose ndonjë detyrimi të përcaktuar me ligj;

3.4 Në rastet e dëbimit ose ekstradimit.

D./4 Sqarimin e një rrethane:

4.1 Të personit për të cilin ka dyshime të arsyeshme se ka kryer veprë penale;

4.2 Për të parandaluar kryerjen e një veprë penale;

4.3 Personi është larguar pas kryerjes së një veprë penale;

4.4 Personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, sipas kushteve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale;

4.5 Kur personi është njoftuar për paraqitje në ambientet e policisë (sipas nenit 108 të Ligjit "Për Policinë e Shtetit") dhe pa arsye e shkaqe ligjore nuk është paraqitur.

Në këtë rast qëllimi i njoftimit dhe shoqërimit është : marrja e informacioneve që kanë të bëjnë me :

a) Parandalimin e veprimit ose mosveprimit të kundërligjshëm.

b) Për të identifikuar personin që mund të ketë dijeni për rrezikun apo incidentin.

c) Për të identifikuar shkelësin e mundshëm të ligjit.

Njoftimi për paraqitje bëhet me anë të fletë-thirrjeve ose verbalisht. Nëse personi kundërshton paraqitjen *pa shkaqe të arsyeshme*, aplikohet shoqërimi forcërisht dhe kundër vullnetit të tij.

V. PËRGJEGJËSITË E PUNONJËSIT TË POLICISË NË RASTET E SHOQËRIMIT DHE ZBATIMI I AFATEVE.

1. Punonjësi i policisë ka të drejte të aplikoje masën e shoqërimit dhe mbajë në mjediset e policisë një person për aq kohë sa është e domosdoshme për identifikimin apo sqarimin e rrethanave në ngarkim të tij, por jo më shumë se 10 orë.

2. Afati 10 orësh është kufiri maksimal kohor i mbajtjes së një personi.

Në rast se verifikimet e nevojshme (identifikimi dhe sqarimi i rrethanave) përfundojnë në një kohë më të shkurtër se sa është afati maksimal, oficerit të policisë i paraqiten dy mundësi:

a. Të lirojë menjëherë të shoqëruarin;

b. Të kryej ndalimin/arrestimin e tij, në bazë të nenit 253/2 dhe nenit 251/3 të Kodit të Procedurës Penale;

3. Kur qëllimi i masës së shoqërimit është realizuar brenda një afati kohore më të shkurtër dhe punonjësi i policisë që ka kryer procedurat e verifikimit vazhdon ta mbajë personin, me arsyetimin se nuk është plotësuar afati 10 orë, do konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore dhe mund të ndiqet penalisht në bazë të nenit 250 të K. Penal (Kryerja e veprimeve arbitrare).

4. Punonjësi i policisë ka detyrimin të njoftojë menjëherë **sallën e komandimit dhe eprorin e tij ose institucionin e interesuar për rastin e shoqërimit.**

Drejtuesi i strukturës policore, nëse çmon se shoqërimi nuk është i mbështetur në ligj, urdhëron menjëherë lirimin e të shoqëruarit.

5. Të drejtën për të vendosur lirimin e personit të shoqëruar, pasi janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme, e ka oficeri i policisë që kryen procedurat e verifikimit të çështjes, i cili plotëson dokumentacionin përkatës dhe njofton eprorin e tij për masën e lirit të personit.

6. Kur akti/veprimi i shoqërimit kryet nga Oficeri/agjenti i Policisë Gjyqësore për personin nën hetim, në bazë të nenit 295.2 të Kodit të Procedurës Penale, afati kohor i mbajtjes së personit nën hetim është 12 orë. Në këtë rast oficeri i policisë gjyqësore duhet të njoftojë menjëherë prokurorin. Prokurori, nëse çmon se shoqërimi nuk është i mbështetur në ligj, urdhëron menjëherë lirimin e të shoqëruarit.

Shoqërimi i personit nën hetim kryet nga Oficeri/agjenti i Policisë Gjyqësore vetëm për qëllimet e më poshtme :

- a. personi refuzon të deklarojë gjeneralitet;
- b. rezultojnë elementë të mjaftueshëm për të dyshuar se personi ka deklaruar gjeneralitete të rreme;
- c. Personi nuk zbaton urdhrin apo thirrjen e bërë me shkrim nga policia gjyqësore për tu paraqitur pranë oficerit të policisë gjyqësore.

7. Procedurat e dokumentimit të shoqërimit të detyrueshëm për personin në hetim, kryhen sipas përcaktimeve të nenit 303 të Kodit të Procedurës Penale.

VI. ZBATIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE SIGURIA PËR PERSONIN E SHOQËRUAR

Në të gjitha rastet e shoqërimeve, punonjësit e policisë janë të detyruar të njohin dhe zbatojnë të drejtat e personave të shoqëruar, si dhe japin siguri për jetën, shëndetin, kushtet e qëndrimit dhe trajtimit human në këto ambiente.

1. Të drejtat e personave të shoqëruar

Personat e shoqëruar kanë këto të drejta që jua njeh ligji:

- a. Të trajtohet në mënyrë humane, njerëzore dhe dinjitoze pa diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, besimit, etnisë, bindjeve politike, fetare ose filozofike, orientimit seksual, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë prindërore.
- b. Personi i shoqëruar nuk mund të mbahet përtej afatit kohor që nevojitet për sqarimin e pozitës dhe çështjes, në çdo rast zbatohen përcaktimet e pikës "V" të kësaj procedure.
- c. Personi i shoqëruar ka të drejtë që të njihet menjëherë me arsyet e shkaqet e shoqërimit,
- d. Nuk ka detyrim të bëjë ndonjë deklaratë,
- e. Të komunikojë me një person të besuar, avokat apo mbrojtësin ligjor.
- f. T'i vihet në dispozicion një kopje e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarin.

g. Të ketë akses të vazhdueshëm (sa herë që kanë nevojë) për të kryer nevojat personale si dhe për ujë të pijshëm.

gj. Të njoftojë një pjesëtar të familjes/të afërm apo persona të tjerë të zgjedhur prej tij, lidhur me faktin e shoqërimit dhe vendndodhjes. Në këtë rast njoftimi kryhet nga i shoqëruari në prezencë të punonjësit të policisë dhe në pamundësi të mjeteve të njoftimit kryhet nga punonjësi i policisë me mjete të drejtorisë, komisariatit apo stacionit të policisë.

Në rastet kur njoftimi nuk mund të kryhet me mjete të komunikimit telefonik, njoftimi kryhet verbalisht nga punonjësit e policisë të territorit ku gjendet familjari, i afërmi apo personi i caktuar prej të shoqëruarit.

Për personat e mitur njoftimi i familjarëve apo kujdestarit ligjor kryhet në mënyrë të detyrueshme dhe në raste kur një gjë e tillë refuzohet nga i mituri.

Njoftimi i prindërve apo kujdestarit ligjor kryhet jo më vonë se 3 orë nga koha e shoqërimit të personit të mitur.

k. Të paraqesë kërkesa apo ankesa për mënyrën e shoqërimit, mbajtjes, trajtimit dhe respektimit të të drejtave nga personeli policor gjatë shoqërimit dhe mbajtjes në ambientet e policisë.

2. Veçori të mbajtjes së shoqëruar të të miturve, të huajve, të sëmurëve

a. Në çdo rast kur i shoqëruari është i mitur, strukturat e policisë/personi i ngarkuar me sqarimin e çështjes, realizojnë njoftimin detyrimisht të personit përgjegjës për mbikëqyrjen e tij (prindërit, kujdestari ligjor) edhe në rastet kur refuzohet nga personi i shoqëruar i mitur.

Në këtë mënyrë veprohet dhe për personat në moshë madhore, për të cilët është caktuar një kujdestar ligjor.

b. Në rastet e shoqërimit të shtetasit të huaj të vihet në dijeni strukturat përkatëse të Ministrisë së Punëve të Jashtme, nëpërmjet shërbimit të sallës së Komandimit në D.P.Sh, si dhe sigurimi i një përkthyesi që komunikon në gjuhën që flet personi i shoqëruar i huaj.

c. Kur vlerësohet se personi i shoqëruar ka nevojë për përkujdes mjekësor, merren masat e nevojshme për dhënien e ndihmës mjekësore si dhe kur është e domosdoshme, dërgohet për trajtim në qendrat spitalore të qytetit, rrethit apo ato rajonale.

d. Personat që vuajnë nga sëmundje apo janë me çrregullime të shëndetit mendor dhe gjendja e tyre shoqërohet me sjellje agresive patologjike ose seriozisht të pa përgjegjshme që mund të shkaktojnë dëmtim të vetë personit, personave të tjerë, ambientit përreth, etj shoqërohen në ambientet e institucioneve shëndetësore për dhënien e ndihmës dhe trajtimin përkatës të specializuar.

3. Kushtet e mbajtjes dhe Siguria për personat e shoqëruar

Për mbajtjen e personave të shoqëruar në ambientet e policisë krijohen kushte të nevojshme të përshtatshme të ndryshme nga ato të dhomave të sigurisë ku garantohet siguria dhe trajtimi njerëzor i tyre, si më poshtë :

- a. Personat e shoqëruar mbahen në mjedise e ambiente me kushte të ndryshme nga ato që shërbejnë për mbajtjen e personave të arrestuar/ndaluar (dhomat e sigurisë).
- b. Mjediset/ambientet të jenë të ndara më vehte për persona të rritur, femra dhe të mitur. Këto mjedise të jenë brenda ndërtesave të drejtorive, komisariateve dhe stacioneve të policisë.
- c. Mjediset të jenë me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrimin e personave të jenë të lyera, të pastra nga higjienike si dhe të kenë dritare me përmasa të tilla që të krijojnë mundësi për realizimin e ajrimit e ndriçimit të plotë natyral.
- d. Në mjediset ku pyetet i shoqëruari të kenë të vendosura pajisje e orendi pune për specialistët e ndihmës specialistët e policisë si; tavolina e karrige si dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, të cilat të jenë të fiksuara dhe të pa lëvizshme.
- e. Brenda këtyre ambienteve ose ngjitur me to, të ketë tualete, të ndara për femra dhe meshkuj, të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim.
- f. Në të gjitha mjediset të mos mbahen sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësit të policisë.
- g. Dritaret e këtyre mjedisëve të jenë të siguruara me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise.

4. Rregullat e sigurisë gjatë kryerjes së veprimeve me personat e shoqëruar.

- a. Personat e shoqëruar vendosen dhe mbahen në dhoma/ambiente të caktuara për të shoqëruarit në polici, të cilat plotësojnë kushtet e sigurisë, për mos largimin etyre.
- b. Mbahen e sigurohen të mbyllur në dhomën e shoqërimit personat e shoqëruar sipas përcaktimeve të bëra në :
 - a.1. Nenin 109 pika 1, germat : a, c, ç, d, dh, f, të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.
- c. Çelësi i dhomave ku mbahen/akomodohen këta persona mbahet dhe administrohet sipas rastit nga një punonjës policie i funksionit:
 - b.1. Ndihmës specialist përgjegjës grupi e informacioni.
 - b.2. Ndihmës specialist për informacionin.
 - b.3. Trupë shërbimi e përgjegjës informacioni.
 - b.4. Ose punonjësi i policisë i ngarkuar me detyrë për evidentimin, trajtimin dhe menaxhimin e të shoqëruarve.
- ç. Personat e shoqëruar deri në sqarimin e pozitës dhe arsyes së shoqërimit mbahen në ruajtje dhe monitorim të punonjësit të policisë të funksionit të caktuar ose me mjete të tjera dixhitale (*sisteme të kamerave video – audio*).

Për sigurimin e trajtimin e personave të shoqëruar femra, caktohen me shërbim punonjës policie femra.

d. Për kërkesat që kanë kjo kategori personash për të kryer nevojat personale apo nevoja shëndetësore, punonjësi i shërbimit të sigurimit të shoqëruarve komunikon me punonjës të shërbimit të përcaktuar në germën "c" të pikës 4 të sipërpërmendur, i cili kryen këto veprime:

d.1. Vlerëson rrezikshmërinë që paraqet personi konkret, vendin/largësinë ku gjendet tualeti dhe kushtet e sigurisë që plotëson ky ambient.

d.2. Nëse çmon të nevojshme komunikon dhe vë në dijeni eprorin e tij (specialistin e rendit/shefin e seksionit të rendit/shefin e seksionit të patrullës së përgjithshme) për të caktuar punonjës policie për mbështetjen dhe kryerjen e sigurt të veprimeve për nxjerrjen, dërgimin e të shoqëruarit për kryerje të nevojave personale dhe kthimin e tij në dhomën e shoqërimit.

d.3. Pasi është siguruar prezenca e punonjësve të tjerë të policisë - kryen hapjen e derës së dhomës ku është i shoqëruari, nxjerrjen dhe shoqërimin e tij për në tualet dhe pas përfundimit kryejnë shoqërimin e tij për në dhomën e shoqërimit, duke mbyllur derën e dhomës me çelës/dryn dhe marrë çelësin me vete.

Nxjerrja e të një të shoqëruari nga dhoma për në tualet, kryhet minimalisht me jo më pak se dy punonjës policie.

d.4. Gjatë kryerjes së nevojave personale punonjësit e policisë qëndrojnë jashtë dhe pranë derës së tualetit, në pritje të daljes së personit të shoqëruar.

Nëse personi i shoqëruar tejkalon kohen normale/të nevojshme të kryerjes së nevojave personale, punonjësit e policisë realizojnë hapjen e derës (nëse është e nevojshme dhe me forcë) dhe nxjerrjen e personit të shoqëruar.

e. Punonjësi i policisë i shërbimit të sigurimit të shoqëruarve, për dërgimin e personave të shoqëruar të përcaktuar në germën "b" të pikës 4 - për në zyrën e intervistimit apo zyrën e punës të specialistit/ndihmës specialistit/oficerit të policisë gjyqësore, kryen këto veprime e merr këto masa :

e.1. Shoqëron personin duke marrë masat e sigurisë të përcaktuara në germën "d2" dhe "d3" të mësipërme.

e.2. Dorëzon personin e shoqëruar specialistit/ndihmës specialistit/oficerit të policisë gjyqësore, i cili është ngarkuar për të intervistuar apo kryer veprime të tjera procedurale, duke pasqyruar këtë fakt në regjistrin për këtë qëllim (regjistri model nr. 4).

e.3. Në përfundim të intervistimit apo veprimeve të tjera procedurale specialisti/oficeri i policisë gjyqësore njofton punonjës të policisë sipas funksionit përkatës, i cili së bashku me punonjës të tjetër të policisë kryejnë marrjen, shoqërimin dhe futjen në dhomën e shoqërimit të personit të shoqëruar.

f. Nëse nga ana e shërbimit të policisë gjyqësore do të kryhet arrestimi apo ndalimi i personit të shoqëruar, merren këto masa sigurie :

- f.1. Kërkohe dhe sigurohet prezenca e punonjësi policie (*i strukturave të rendit apo atyre për krimet*) gjatë plotësimit të procesverbaleve të arrestimit apo ndalimit dhe kontrollit personal të personit.
- f.2. Njoftohet menjëherë dhe sigurohet sa më shpejt që të jetë e mundur prezenca e punonjësit të policisë të funksionit : ndihmës specialist përgjegjës/zv.përgjegjës i dhomave të sigurisë i cili merr në dorëzim të arrestuarin/ndaluarin, sendet personale të tij dhe kopje të dokumentacionit përkatës të përpiluar nga oficeri i policisë gjyqësore.
- f.3. Ndihmës specialisti përgjegjës/zvëndëspërgjegjës i dhomave të sigurisë i shoqëruar nga punonjësi i policisë i shërbimit për informacionin dhe një punonjës tjetër policie kryejnë shoqërimin e personit të ndaluar/arrestuar për në dhomat e sigurisë.

g. Gjatë kryerjes së veprimeve me personat e shoqëruar, sigurohen të lidhur me pranga në duar (*me duar prapa*) të shoqëruarit të cilët janë :

- g.1. Autorë/bashkautorë të veprës penale.
- g.2. Të kapur në kushtet e flagrancës së kryerjes së veprës penale.
- g.3. Të dënuar me burgim nga gjykata.
- g.4. Personat ndaj të cilëve gjykata ka caktuar si masë sigurie “arrest në burg”.
- g.5. I dyshuar (dyshime të arsyeshme) se ka kryer vepër penale.
- g.6. Të shpallur në kërkim policor apo nga organet e drejtësisë vendase apo të huaja.
- g.7. Të dhunshëm, kundërshtojnë policinë dhe ata për të cilët ka informacione se mund të tentojnë të largohen me forcë nga ambientet e policisë.

h. Gjatë kryerjes së veprimeve me persona të shoqëruar të seksit femër, është e detyrueshme që të sigurohet prezenca e një punonjësi policie të seksit femër.

i. Marrja dhe dorëzimi i personit të shoqëruar midis shërbimit të ngarkuar për ruajtjen/sigurimin e tyre dhe specialistëve/ndihmës specialistëve të policisë (dhe anasjelltas) që kryejnë veprimet për sqarimin e trajtimin e shkakut/arsyes së shoqërimit kryhet nëpërmjet nënshkrimit në regjistrin përkatës, sipas Lidhjes nr. 4, bashkëlidhur dhe pjesë të kësaj procedure.

5. Komunikimi me personat e shoqëruar.

Kanë të drejtë të komunikojnë me personat e shoqëruar :

- 5.1. Punonjësi i shërbimit të ruajtjes dhe sigurimit të tyre në ambientet e policisë.
- 5.2. Punonjësi i policisë përgjegjës për trajtimin dhe menaxhimin e të shoqëruarve.
- 5.3. Punonjësi i policisë që ngarkohet për të kryer veprimet e sqaruar rrethanat/shkakun e shoqërimit të personit.
- 5.4. Personeli mjekësor në rastet e kontrollit dhe dhënies së ndihmës mjekësore.
- 5.5. Drejtues të shërbimeve policore të komisariatit, drejtorisë vendore dhe Drejtorisë të Policisë së Shtetit gjatë kryerjes së kontrolleve për masat e sigurisë, trajtimin që ju bëhet këtyre personave dhe nivelin e respektimit dhe garantimit të të drejtave të tyre.

5.6. Përfaqësues të Avokatit të Popullit, organizatave të shoqërisë civile për mbrojtjen e të drejtave të njeriut me të cilat Policia e Shtetit ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe janë të pajisur me autorizime/leje të veçantë nga Drejtoria e Përgjithshme për Sigurinë Publike.

5.7. Personat sipas pikës 3, të nenit 109 të Ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit. (prindi/kujdestari/një person i besuar, psikologu, avokati mbrojtës).

5.7. Punonjësit e policisë dhe përfaqësuesit e OJQ/OJF sipas përcaktimeve, komunikojnë me personin e shoqëruar lidhur me ankesat/kërkesat që mund të kenë, trajtimin që ju është bërë dhe realizimin apo jo të të drejtave që ju njeh ligji.

Ndalohet komunikimi dhe pyetja e të shoqëruarve për akuzën që ju bëhet, rrethanat e kryerjes së veprës penale, me përjashtim të përfaqësuesve të organit të akuzës (o.p.gj e prokuror) dhe avokat mbrojtës.

VII. PROCEDURA TË DOKUMENTIMIT TË VEPRIMIT TË SHOQËRIMIT

Akti/veprimi i shoqërimit, detyrimisht, evidencohet e dokumentohet në sistem elektronik, në regjistra, në formularë dhe procesverbale.

Procedurat e evidentimit të veprimeve që janë kryer me të shoqëruarin kryhet nga punonjësi i policisë që ka punuar dhe sqaruar çështjen, ndërsa hedhja e të dhënave në regjistër dhe në sistemin elektronik të të dhënave kryhen nga punonjësi i policisë të shërbimit të informacionit në njësinë policore.

Mos zbatimi i kësaj kërkesë nga personat përgjegjës për dokumentimin e aktit të shoqërimit, përbën shkelje të rëndë disiplinore.

1. Evidentimi i veprimeve dhe të dhënave, që kryhen me personat e shoqëruar bëhet në rrugë:

- a. Manuale,
- b. Elektronike.

a. Dokumentimi i të dhënave në rrugë manuale kryhet në :

a.1 - Regjistrin e Evidentimit të të Dhënave për Personat e Shoqëruar. (*lidhja 1*),

a.2 - Formularin e Raportit të Shoqërimit (*lidhja 2*),

a.3 - Proces verbalin e veprimeve të kryera me personin e shoqëruar (*lidhja 3*).

a.1.1 - Hedhja e të dhënave në Regjistrin e Evidentimit të të Dhënave për personat e Shoqëruar kryhet nga punonjësi i shërbimit të funksionit : ndihmës specialist për informacionin të strukturave të rendit publik të njësisve policore.

Këto të dhëna hidhen menjëherë dhe pa vonesë në regjistër pas mbërritjes/shoqërimit të personit nga punonjësi i policisë dhe akomodimit të tij në ambientet e shoqërimit.

a.1.2 - Regjistri i Evidentimit të Personave të Shoqëruar:

a.1.3 - Regjistri i Evidentimit të Personave të Shoqëruar mbahet dhe është pjesë e dokumentacionit të punës së funksionit policor: ndihmës specialist për

informacionin/përgjegjës për informacionin apo punonjësi i ngarkuar me këtë detyrë, në strukturat e rendit publik, është i tipit dhe modelit të përcaktuar (sipas lidhjes nr. 1), i cili para se të vihet në përdorim protokollohet në arshivë/sekretarinë e njësisë policore.

a.1.4 - Për personat e shoqëruar, evidentohen të dhënat e mëposhtme :

- a. Emri, atësia, mbiemri, datëlindja, vendlindja.
- b. Adresa e saktë e vendbanimit.
- c. Pamja e jashtme e personit duke përfshirë dhe shenja të veçanta që mund të kenë (*me një dorë apo një sy, shenja djegieje apo plage, tatuazhe, nishane etj*)
- d. Puna apo veprimtaria që kryen.
- e. Arsyet e shkaqet e shoqërimit.
- f. Drejtorinë/komisariat/stacionin e policisë dhe zyrën përkatëse ku është kryer shoqërimi.
- g. Emrin, mbiemrin e funksionin e punonjësit të policisë që ka kryer shoqërimin.
- h. Ora, data e shoqërimit.
- i. Ora, data e lënies së lirë të personit.
- j. Punonjësi i policisë që punoi për verifikimin e zgjidhjen e çështjes së personit të shoqëruar.
- k. Të dhënat për realizimin e të drejtës për njoftimin e familjarëve/afërmve për shoqërimin si: emri, atësia, mbiemri dhe numri i telefonit të personit që është njoftuar për faktin e shoqërimit dhe të vend ndodhjes së personit të shoqëruar, si dhe orën e njoftimit.
- l. Masa e marrë pas verifikimit të rrethanave dhe sqarimin e pozitës të personit të shoqëruar, (këshilluar, gjobitur, arrestuar/ndaluar, lënë i lirë, dërguar për trajtim në qendrat shëndetësore, dërguar pranë gjykatës apo prokurorisë, dorëzuar prindërve/kujdestarit, në qendrat e kujdesit për të miturit, etj).

Punonjësi i shërbimit të informacionit nuk pranon dhe nuk merr në dorëzim personin e shoqëruar pa u plotësuar dhe dorëzuar formulari i raportit të shoqërimit.

a.2 - Formulari i Raportit të Shoqërimit

a.2.1 - Formulari i raportit të Shoqërimit plotësohet nga punonjësi i policisë që ka kryer shoqërimin e personit, menjëherë pas shoqërimit të personit në ambientet e policisë/ambientet e shoqërimit.

a.2.2 - Formulari i raportit të Shoqërimit plotësohet në dy kopje dhe pasi plotësohet sipas kërkesave dhe rubrikave të parashikuara në të, i dorëzohet punonjësit të shërbimit të informacionit, i cili e kontrollon për saktësinë dhe korrektësinë e plotësimit.

a.2.3 - Nëse nga punonjësi i shërbimit të informacionit konstatohen parregullsi në plotësim ja kthen punonjësit të policisë për ta ri plotësuar dhe njëkohësisht vë në dijen i eprorin e drejtpërdrejtë të punonjësit të policisë.

a.2.4 - Një kopje e Formularit të Raportit të Shoqërimit i jepet punonjësit të policisë që ngarkohet për të sqaruar e trajtuar arsyen/shkakun e shoqërimit dhe zgjedhjen e çështjes për personin e shoqëruar dhe kopja tjetër administrohet nga punonjësi i

shërbimit të informacionit i cili në fund të çdo jave i dorëzon në sekretari/arshivën e njësisë policore.

a.3 - Proces verbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar:

a.3.1 - Pas kryerjes së veprimeve të verifikimit e sqarimit të rastit për personin e shoqëruar, nga punonjësi i policisë hartohet procesverbali i dokumentimit të veprimeve të kryera me personin e shoqëruar.

a.3.2 - Ky procesverbal pasi plotësohet duke hedhur të gjithë të dhënat sipas përcaktimeve dhe rubrikave të përcaktuara në të, nënshkruhet në fund të çdo faqeje nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe nga vetë personi i shoqëruar.

a.3.3 - Proces verbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar plotësohet nga punonjësi i policisë që është ngarkuar të kryejë verifikimin dhe trajtimin e çështjes përkatëse për personin e shoqëruar.

a.3.4 - Procesverbali hartohet në dy kopje, një kopje e procesverbalit i jepet detyrimisht personit të shoqëruar dhe kopja tjetër dorëzohet në sekretari/arshivën e njësisë policore.

Mos plotësimi i procesverbalit dhe mos dhënia e një kopjeje personit të shoqëruar përbën shkelje të rëndë dhe ndëshkohet sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren e Policisë.

b. Dokumentimi i të dhënave në rrugë elektronike:

b.1 - Hedhja e të dhënave në rrugë elektronike kryhet në sistemin elektronik ADAM, nga punonjësi i policisë të funksionit : ndihmës specialist për informacionin apo punonjësi i ngarkuar me këtë detyrë, në strukturat e rendit publik të njësive policore.

b.2 - Hedhja e të dhënave në sistemin ADAM kryhet menjëherë pas mbarimit të shoqërimit në ambientin e shoqërimit dhe plotësimit të Formularit të Raportit të Shoqërimit.

Mos hedhja në kohë e të dhënave për personat e shoqëruar, përbën shkelje të rëndë të disiplinës, dhe për punonjësin e policisë përgjegjës kryhen veprimet për fillimin e ecurisë disiplinore dhe dhënien e masës disiplinore përkatëse.

b.3 - Rregullat për hedhjen, administrimin dhe përgjegjësitë e funksioneve policore për hedhjen e administrimin e të dhënave për personat e shoqëruar në sistemin ADAM përcaktohen në Procedurën Standarde të miratuar për këtë qëllim.

Një herë në tre muaj drejtuesit e strukturave vendore të policisë analizojnë punën dhe zbatimin e procedurave për hedhjen e administrimin e të dhënave për personat e shoqëruar, menaxhimi dhe trajtimi i tyre, respektimin dhe garantimin e të drejtave që ju njih ligji, duke evidentuar problematikat, mangësitë dhe përcaktimin e detyrave për përmirësimin e gjendjes dhe eliminimin e mangësive.

VIII. PROCEDURA DHE RREGULLAT TEKNIKE TË SHOQËRIMIT.

1. Gjatë shoqërimit, punonjësit e policisë janë të detyruar të marrin masa sigurimi shtesë në vartësi të rastit dhe qëllimit të shoqërimit, në vartësi të personit që shoqërohet, vendit, kohës, numri i personelit policor apo i personave që shoqërohen si dhe mënyrës së shoqërimit.
2. Masat e sigurisë shtesë gjatë shoqërimit aplikohen si për eliminimin e kundërshtimit apo kundërveprimit të personit të shoqëruar ashtu dhe për të siguruar personin e shoqëruar nga veprime të kundërligjshme.
3. Në të gjitha rastet, për momentin e fillimit të shoqërimit duhet të njoftohet salla operative e drejtimit, e cila mban kontakt të vazhdueshëm deri në mbërritjen e të shoqëruarit në mjediset e policisë
4. Mënyrat e realizimit të shoqërimit janë : në këmbë dhe me automjet

4.1 Shoqërimi në këmbë:

Ky shoqërim konsiston në marrjen dhe shoqërimin e personit me punonjës policie duke lëvizur në këmbë nga vendi ku kontaktohet/merret personi deri në drejtorinë/komisariatën/stacionin e policisë.

Shoqërohen në këmbë (në distancë relativisht të shkurtra) personat sipas përcaktimeve të mëposhtme :

- a. Personat që nuk paraqesin rrezikshmëri të theksuar shoqërore.
- b. Nëse dihet që nuk kanë qenë të dënuar më parë për kryerje të veprave penale
- c. Që nuk janë autorë apo të dyshuar për kryerje të veprave penale.
- d. Që nuk janë nën efektet e lëndëve narkotike dhe atyre alkoolike.
- e. Që nuk janë invalidë.
- f. Si dhe ata persona për të cilët nuk ka të dhëna se gjatë shoqërimit do të kundërshtojnë apo tentojnë të largohen me forcë.

4.2 Procedurat dhe veprimet që kryen nga punonjësi i policisë gjatë shoqërimit në këmbë :

- a. Vlerëson situatën e sigurohet që po shoqëron personin e duhur duke kontrolluar dokumentin e identifikimit apo njohjen nga vetë punonjësit e policisë.
- b. Ruan distancën e sigurisë ndaj personit, komunikon arsyen e shoqërimit dhe urdhrin për të shkuar së bashku në njësinë policore.
- c. Sipas rastit njëri nga policët kryen fillimisht një kontroll sipërfaqësor të personit me prekje me duar të veshjeve të tij/saj nga jashtë, për të hequr sendet e kundërligjshme që mund të ketë me vete.
- d. Personi i shoqëruar mund të mbahet i kapur për krahu nga një apo të dy punonjësit e policisë.
- e. Gjatë shoqërimit nuk lejojnë që i shoqëruari të ndalojë, të komunikojë me persona të tjerë, të hyjë në ambiente të tjera me justifikimin se do të kryejë nevojat personale.
- f. Në rast të acarimit të situatës si tentativa nga persona të tjerë për të liruar personin e shoqëruar punonjësi i policisë kërkon menjëherë ndihmë për të

dërguar automjet për realizimin e shoqërimit, pozicionohet në një vend të përshtatshëm duke siguruar të shoqëruarin deri në ardhjen e mjetit të policisë dhe punonjësve të tjerë të policisë.

4.3 Shoqërimi me automjet të shërbimit të policisë:

Ky shoqërim konsiston në marrjen dhe shoqërimin e personit apo personave nga vendi i kontaktimit/marrjes deri në njësinë policore përkatëse me automjete të shërbimit të policisë apo automjete të tjera, të cilat merren e vihen në dispozicion të policisë.

Me automjete të shërbimit policor apo jo policor shoqërohen personat të cilët zakonisht paraqesin rrezikshmëri të theksuar shoqërore, janë autorë apo bashkautorë të veprave penale, kanë qenë të dënuar nga gjykatat për kryerje të veprave penale, janë nën efektet e lëndëve narkotike dhe ato alkoolike, si më poshtë :

- a. Personat e dënuar me burgim nga gjykata.
- b. Personat për të cilët ka dyshime të arsyeshme se ka kryer vepër penale.
- c. Për të parandaluar kryerjen e një vepre penale.
- d. Personat që janë autorë dhe janë larguar pas kryerjes së një vepre penale.
- e. Personat që janë bartës dhe përhapës të sëmundjeve ngjitëse. Në këtë rast personi shoqërohet me automjete të shërbimit mjekësor dhe nën mbikëqyrjen e personelit mjekësor.
- f. Personave që vuajnë nga sëmundje të shëndetit mendor dhe janë të rrezikshëm për shoqërinë.

4.4 Rregullat e sigurisë gjatë shoqërimit me automjet :

Gjate shoqërimit me automjet punonjësi i policisë kryen këto procedura të domosdoshme për sigurinë e shoqërimit dhe të vetë të shoqëruarit.

- a. Sigurohuni që po shoqëroni personin e duhur duke kontrolluar dokumentin e identifikimit apo njohjen nga vetë punonjësit e policisë.
- b. Komunikoni personit arsyen e shoqërimit.
- c. Kryeni kontrollin sipërfaqësor të personit me prekje me duar të veshjeve të tij nga jashtë, për të hequr sendet personale apo dhe të kundërligjshme që mund të ketë me vete, duke i paketuar e mbajtur në qese plastike apo ambalazh tjetër.
- d. Prangosni personin me duar prapa dhe hipeni në automjet të shërbimit.
- e. Asnjëherë personin e shoqëruar mos e lini vetëm në ndenjësen e automjetit por minimalisht të ketë në njërin krah një punonjës policie i cili mban nga krahu personin e shoqëruar.
- f. Asnjëherë personi i shoqëruar të mos vendoset dhe mbahet nga pas ndenjësës së drejtuesit të mjetit të shërbimit.
- g. Zgjidhni rrugën më të shkurtër dhe me më pak ngarkesë në trafik për të shkuar në organin e policisë.
- h. Mos u angazhoni me kryerje të detyrave të tjera duke pasur me vete personin e shoqëruar.
- i. Gjatë shoqërimit me automjet siguroni armatimin personal të brezit si dhe ato të krahut nëse keni, të cilat të mos kenë kontakt me personin e shoqëruar.
- j. Mbani kontakt dhe informoni herë pas here shërbimin e sallës drejtimit.

4.5 Shoqërimi i personave duke i prangosur.

4.5.1- Një nga mjetet që i janë dhënë Policisë së Shtetit për ti vënë në përdorim gjatë përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësive ligjore janë dhe prangat lidhëse, të cilat u jepen punonjësve të policisë si pajisje personale për shërbim.

4.5.2- Jo të gjithë personat që shoqërohen në organin e policisë apo organin/institucionin urdhërdhënës shoqërohen të prangosur me hekura lidhës.

4.5.3- Shoqërohen të lidhur/prangosur me hekura lidhës :

- a. Personat e dënuar me vendim të formës së prerë me burgim nga gjykata kompetente.
- b. Personat që janë autorë/bashkautorë apo të dyshuar se kanë kryer veprave penale.
- c. Personat që largohen menjëherë pas kryerjes së veprave penale.
- d. Personat që vuajnë nga sëmundje të shëndetit mendor (të pa aftë mendërisht) dhe të rrezikshëm për shoqërinë ;
- e. Personat të cilët kundërshtojnë me forcë e dhunë punonjësit e policisë gjatë shoqërimit
- f. Personat, gjendja e të cilëve tregon qartë se nuk mund të kontrollojë veprimet dhe sjelljen e tyre dhe për këtë arsye mund t'i shkaktojë dëmtime fizike ose përbjëjë rrezik për jetën e tij, ose të tjerëve, si :
 - Të sëmurët mendorë.
 - Të dehurit nga konsumimi i tepërt i pijeve alkoolike.
 - Ata që janë në efektet e përdorimit të lëndëve narkotike.

4.6 Rregullat dhe procedurat për kryerjen e kontrollit ndaj të shoqëruarve :

- a. Për kontrollin e personave të shoqëruar zbatohen rregullat e Kodit të Procedurës Penale si dhe ato e përcaktuara në procedurën standarde të punës "Për kontrollin fizik".
- b. Kontrolli në ambientet e policisë/dhomat e shoqërimit kryhet nga punonjësi i policisë të funksionit ndihmës specialist përgjegjës grupi e informacioni, të drejtorisë/komisariatit të policisë ku shoqërohet personi.
- c. Kontrolli i personave të shoqëruar kryhet gjithmonë në prezencën e punonjësve të policisë që kanë kryer shoqërimin.
- d. Punonjësit e policisë që kanë kryer shoqërimin dorëzojnë shërbimit të informacionit dhe sendet/mjetet që mund të jene gjetur me vete personit të shoqëruar në momentin e parë të kapjes/bllokimit të terren.
- e. Kontrolli i të shoqëruarve të seksit femër si rregull kryhet nga punonjës policie i të njëjtit seks.
- f. Nëse personi i shoqëruar refuzon apo kundërshton që ti nënshtrohet kontrollit fizik, ky kontroll kryhet forcërisht kundra vullnetit të tij. Për përdorimin e forcës zbatohen rregullat dhe procedurat e përcaktuara në Procedurën standarde të punës "Përdorimi i Forcës".
- g. Kontrolli i personit të shoqëruar kryhet duke respektuar personalitetin, dinjitetin dhe pa diskriminim të personit që kontrollohet.

5. Rregullat dhe procedurat për shoqërimin dhe trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor.

5.1. Shoqërimi i kësaj kategorie personash në institucionet shëndetësore paraqet veçori për vet faktin/gjendjen e veçantë në të cilën janë apo ndodhen këta persona e cila i bën të paaftë për të menduar, gjykuar, perceptuar, kujtuar dhe përmbushur kërkesat e jetës.

5.2. Strukturat vendore të policisë bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacione me autoritetet shtetërore shëndetësore që kujdesen për personat me çrregullime të shëndetit mendor, organet e pushtetit vendor dhe organizatat jofitimprurëse që veprojnë në këtë fushë për të evidentuar personat që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor.

5.3. Evidentimi i këtyre personave bëhet në dokumentacionin përkatës nga funksioni ndihmës specialist të policimit në komunitet – SPZ.

5.4. Të drejtat e personave me çrregullime të shëndetit mendor:

Kjo kategori personash gëzon të drejtat ligjore si :

- a. Ushtrimi i të drejtave të personave me çrregullime të shëndetit mendor, kryhet në përputhje me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.
- b. Trajtimi i barabartë dhe pa diskriminim i personave me çrregullime të shëndetit mendor, në funksion të respektimit të integritetit fizik dhe dinjitetit njerëzor.
- c. Të drejtën për trajtim dhe mbrojtje, bazuar në respekt të individualitetit dhe dinjitetit të tyre.
- d. Të drejtën për të marrë informacionin e duhur për të drejtat e tyre.
- e. Të drejtën për ruajtjen e konfidencialitetit mbi të dhënat për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore.
- f. Të drejtën për t'u siguruar dhe patur kushtet e përshtatshme jetësore, higjienike, të ushqyerjes dhe sigurisë.
- g. Të drejtën për t'u ankuar për qëndrimin, sjelljen dhe veprimet e kryera nga personeli policor gjatë shoqërimit, mbajtjes dhe trajtimit të tyre.
- h. Personave me çrregullime të shëndetit mendor u sigurohet mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin, në bazë të ligjit nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor” dhe legjislacionit në fuqi për këtë kategori personash.
- i. Asnjë person me çrregullime të shëndetit mendor nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit ose trajtimit mizor, çnjerëzor apo poshtëruës.
- j. Kufizimi i të drejtave të personave me çrregullime të shëndetit mendor kryhet sipas përcaktimeve ligjore, në përpjesëtim të drejtë me gjendjen e diktuar shëndetësore dhe nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave të tyre.

5.5. Shoqërimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor :

Në kuptimin e kësaj procedure standarde pune, shoqërimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor kryhet si masë mbrojtëse për të garantuar dhe parandaluar ngjarje të rënda që këta persona mund ti shkaktojnë vetvetes, familjarëve/të afërmeve, personave të tjerë në komunitet, personelit mjekësor, ambientit, pronës publike dhe private, etj.

5.5.1 Shërbimet e Policisë së Shtetit kryejnë detyra për dhënien e ndihmës ndaj personelit mjekësor dhe shoqërimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor (*që nuk janë subjekt i veprave penale*) në rastet e mëposhtme :

a. Me kërkesë të personelit mjekësor.

Shërbimet e policisë, me kërkesë të personelit mjekësor kryejnë detyra për :

1. Dhënien e ndihmës për personelin mjekësor gjatë kryerjes së vizitave/ekzaminimeve mjekësore të personave me çrregullime të shëndetit mendor.

Në këtë rast shërbimet e policisë marrin masa dhe kryejnë këto detyra:

- Sigurojnë informacion të plotë për rastin konkret, situatën e krijuar në institucionin shëndetësor dhe ndihmën e kërkuar.
- Urdhërojnë dhe dërgojnë punonjës policie pranë qendrës/personelit mjekësor që ka kërkuar ndihmën. Numri i punonjësve të policisë përcaktohet në varësi të situatës së krijuar në qendrën mjekësore përkatëse.
- Sigurojnë prezencën e punonjësve të policisë gjatë kryerjes së vizitave mjekësore dhe kryejnë veprime për dhënien e ndihmës për personelin mjekësor gjatë kryerjes së vizitave dhe ekzaminimeve mjekësore ndaj personit me çrregullime të shëndetit mendor.
- Marrja e masave shtrënguese dhe të kufizimit fizik për garantimin e kryerjes së vizitave mjekësore ndaj personave me çrregullime të shëndetit mendor kryhet sipas udhëzimeve të personelit mjekësor.

2. Shoqërimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor për në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor të specializuar, me shtretër.

Detyrat që kryhen nga shërbimet e policisë, në këtë rast janë :

- Sigurojnë informacion të plotë për rastin lidhur me personin që do të shoqërohet, sjelljen dhe agresivitetin e tij, institucionin mjekësor ku të të shoqërohet dhe transferohet personi me çrregullime të shëndetit mendor, etj.
- Urdhërojnë dërgimin e punonjësve të policisë (*shërbime të patrullës përgjithshme, ndihmës specialist të policimit në komunitet – SPZ, etj*) në qendrën përkatëse shëndetësore që ka kërkuar ndihmën për shoqërimin e këtyre personave.
- Realizojnë shoqërimin e personit me çrregullime të shëndetit mendor nga qendra shëndetësore ku është vizituar/ekzaminuar, për në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor të specializuar, me shtretër të përcaktuar nga mjeku specialist duke qenë prezent personeli mjekësor i shërbimeve të urgjencës dhe një person i afërt i tij ose kujdestari ligjor.

b. Me kërkesë të familjarëve/të afërmeve ose përfaqësuesi ligjor, kur mungon ndihma e menjëhershme mjekësore.

Shërbimet e policisë kryejnë shoqërimin e personit me çrregullime të shëndetit mendor në shërbimin e urgjencës mjekësore më të afërt, kur ndihma mjekësore nuk është dhënë në mënyrë të menjëhershme nga personeli përkatës, duke zbatuar rregullat e mëposhtme:

- Evidentojnë kërkesën/njoftimin për ndihmë të bërë nga familjarët, të afërmit apo kujdestari ligjor i personit me çrregullime të shëndetit mendor duke siguruar informacion të plotë për personin konkret, vendndodhjen, situatën e krijuar, etj.
- Dërgimin e punonjësve të policisë për kapjen dhe shoqërimin e personit me çrregullime të shëndetit mendor në shërbimin e urgjencës mjekësore më të afërt me automjete të familjarëve dhe në pamundësi me automjete të shërbimit policor.
- Dorëzimin e personit tek personeli i urgjencës mjekësore për kryerje të vizitave/ekzaminimeve përkatëse.
- Raportimin e të dhënave për personin e shoqëruar në shërbimin e sallës së komandimit/shërbimin e informacionit të njësisë policore, me qëllim pasqyrimin e tyre në regjistrin e personave të shoqëruar.

5.5.2 Shoqërimi i personave për në shërbimin e urgjencës mjekësore më të afërt, kur mungon ndihma e menjëhershme mjekësore, kryhet me praninë e familjarëve, të afërmeve apo kujdestarit ligjor.

Në rastet kur këta persona nuk janë prezent apo nuk mund të sigurohet menjëherë prania e tyre, merren masa për njoftimin dhe vënien në dijeni të tyre mbi shoqërimin e kryer nga policia.

5.5.3 Marrja e masave shtrënguese dhe të kufizimit fizik për vënien në kontroll dhe shoqërimin e personit me çrregullime të shëndetit mendor janë në përputhje dhe në raport të drejtë me veprimet/kundërveprimet e tij, rrezikshmërinë që paraqesin dhe qëllimit që do të arrihet nga punonjësit e policisë.

5.5.4 Shoqërimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor duke i prangosur kryhet vetëm në raste ekstreme/të veçanta kur këta persona tentojnë të largohen me dhunë, tentojnë të kryejnë veprime të tjera të dhunshme ndaj: pjesëtarëve të familjes, personave të tjerë, punonjësve të policisë dhe personelit mjekësor.

5.5.5 Shoqërimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor për në qendrën mjekësore të shëndetit mendor të specializuar, për trajtim në mënyrë të pavullnetshme kryhet me automjeteve të shërbimit të urgjencës.

5.5.6 Shërbimet e policisë gjatë shoqërimit të personave në institucionet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, për trajtim të pavullnetshëm, marrin masa për :

- a. Sigurimin e garantimin e jetës dhe shëndetit të personit me çrregullime të shëndetit mendor.
- b. Parandalimin e kryerjes së veprimeve nga personi në dëm të jetës dhe shëndetit të personelit mjekësor, të familjarëve, kujdestarit ligjor dhe punonjësve të policisë.

5.5.7 Në përfundim të shoqërimit punonjësit e policisë përpilojnë procesverbalin e veprimeve të kryera me të shoqëruarin duke u nënshkruar nga punonjësit e policisë dhe një pjesëtar i familjes ose kujdestari ligjor.
Një kopje e këtij procesverbali i jepet familjes apo kujdestarit ligjor.

5.5.8 Punonjësve të policisë u ndalohet dhënia dhe përhapja e informacionit për të dhënat personale shëndetësore për personat me çrregullime të shëndetit mendor, të njohura apo të marra gjatë kryerjes së shoqërimit.

(Lidhja Model nr. 1)

REGJISTRI I EVIDENTIMIT TË TË DHËNAVE PËR PERSONAT E SHOQËRUAR

Nr.	Emër, atësi, mbiemër	Datëlindja, vendlindja	Adresa e vendbanimit	Puna që kryen	Përshkrim i pamjes së jashtme, (përfshi dhe shenja te veçanta).	Arsyet, shkaqet e shoqërimit	Ora dhe data e shoqërimit	Vendi, zyra ku është shoqëruar	Punonjësi policisë që ka kryer shoqërimit	Te dhëna për njoftimin e familjareve/afërmve			Punonjësi policisë që punoi për zgjidhjen e çështjes	Ora dhe data e lënies të lirë.	Pretendime dhe nënshkrimi i të shoqëruarit.
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Emër, atësi, mbiemër	Nr. telefonit të personit të njoftimit	Ora njoftimit	13	14	15
0															
1															
2															
3															
4															
5															
6															
7															
8															
9															

Miraturar me urdhrin nr. _____, datë _____.20_____, të D.P.SH

(Lidhja model nr. 3)

PROCESVERVAL
I
I VEPRIMEVE TË KRYERA NGA PUNONJËSI I POLICISË ME PERSONIN E
SHOQËRUAR

_____, data, _____.20____, ora _____. Në _____.

(Rrethi)

(drejtoria, komisariati, stacioni policisë)

Bazuar në kërkesat e pikës 5 të nenit 109 dhe nenit 122 të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”;

Unë _____, me detyrë _____,

Përpiloj këtë procesverbal lidhur me veprimet që janë kryer ndaj shtetasit të shoqëruar :
: _____, i datëlindjes _____. _____. _____, i biri i _____, banues në
adresën _____, si më poshtë :

- Shoqërimi i tij është kryer në orën _____, datë _____. _____. 20____, në ambientet e _____.
- Arsyeya e shoqërimit të tij : _____

_____.
- Veprimet e kryera nga punonjësi i policisë: _____

_____.
- Kthimi i sendeve personale të bllokuara përkohësisht : _____
_____.
- Pretendime, ankesa dhe kërkesa lidhur me veprimet/sjelljet e policisë: _____

_____.
- Koha e lënies së lirë : ora _____, data _____. _____. 20____.

Ky procesverbal mbahet në dy kopje, një i jepet personit të shoqëruar dhe kopja tjetër dorëzohet në sekretari/arshivën e njësisë policore.

Procesverbali, pasi u lexua, u konfirmua dhe u nënshkrua nga personat e mëposhtëm:

Punonjësi i policisë që kryen veprimet

Personi i shoqëruar

(gradë, emër, mbiemër i punonjësit policisë)

Personat e pranishëm

1. _____

2. _____

(Lidhja model nr. 4)

Regjistri
I
Marrjes dhe dorëzimit të personit të shoqëruar

N r.	Emri, atësia, mbiemri i personit të shoqëruar	Marrja në dorëzim e të shoqëruarit nga punonjësi policisë që kryen veprimet për trajtimin e zgjidhjen e rastit.			Dorëzimi i të shoqëruarit në dhomat e shoqërimit			
		Data dhe ora e dorëzimit	Grada, emri i punonjësit të shërbimit që dorëzon të shoqëruarin	Grada, emri i punonjësit që merr në dorëzim të shoqëruarin	Grada, emri i punonjësit të policisë që dorëzon të shoqëruarin në dhomat e shoqërimit	Data dhe ora e marrjes në dorëzim	Nënshkrimi i punonjësit të shërbimit që merr në dorëzim të shoqëruarin	Shënime për gjendjen fizike apo ankesa nga i shoqëruari
1	2	3	4	5	6	7	8	9
1								
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								
11								